2. Pamja e jashtme: Të formuara dhe të ngjeshura, me ngjyrë të kultivarit, jo më shumë se 6 gjethe mbrojtëse të shkurtuara në majë dhe me gjatësi të koçanit deri 1 cm (matur nën gjethin e fundit mbajtës), të shëndosha, të pastra.

MADHËSIA E LULELAKRËS, (kg),

1. Të hershme, jo më pak se: 0.300.
2. Të vona, jo më pak se: 0.350.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

“SPECI”

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Lloji: spec për treg, cilësi e parë.
2. Pamja e jashtme: i freskët, me formë tipike të kultivarit, i pastër, i njomë.
3. Ngjyra dhe pjekuria: me ngjyrë jeshile në të verdhë, me pjekuri normale, të pavyskura.
4. Të mos ketë dëmtime të ndryshme e sëmundje.
5. Të mos jenë të kalbura, të ngrira.
1. Diametri - jo më shumë se 4 cm për specat e gjata.
 - jo më shumë se 9 cm për specat e rumbullakët.
 - gjatësia e bishtit jo më shumë se 3 cm.

“KASTRAVECI” (STASH 1754/88)

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Lloji: kastravec për treg, cilësi e parë.
2. Pamja e jashtme: të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë.
3. Përbërja e brendshme e tulit: me tul të fortë e të lëngshëm, farat e pazhvilluara e pa kore të fortë.
4. Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkurë), jo më shumë se 2 %.
5. Nuk lejohen të prekura nga insektet, të kalbura.
6. Diametri - gjerësia: deri në 5 cm.
 - gjatësia: nuk kërkohet.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatën në fuqi.
2. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastëra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.
3. Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Lloji i prodhimit
3. Cilësia
4. Masa bruto dhe neto

“PATELLXHAN” (STASH 1730/ 88)

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

2. Lloji: patëllxhan për treg, cilësi e parë.
3. Pamja e jashtme: karakteristike e kultivarit, të freskëta, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar, me përkulje të lehtë.
4. Ngjyra dhe pjekuria: me ngjyrë të zezë manushaqe, me pjekuri normale, me fletë jeshile me nuancë të dobëta manushaqe, të pa vyshkura.
5. Nuk lejohen dëmtime të ndryshme (të mykura, të kalbura, të ngrira) e sëmundje.
6. Diametri - jo më shumë se 5 cm për patëllxhanët e gjatë..
 - Jo më shumë se 12 cm për patëllxhanët e rrumbullakët.
 - Gjatësia e bishtit jo më shumë se 4 cm.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Perimet amballazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatën në fuqi.
2. Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastëra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.
3. Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Lloji i prodhimit
3. Cilësia
4. Masa bruto dhe neto

“MOLLA” (bazuar në STASH 1752/ 88)

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Lloji: mollë për treg, cilësia e parë
2. Pamja e jashtme: të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha e me bisht.
3. Era, shija dhe pjekuria: me ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime me 3 pjekuri teknike të njëjtë, pa erë e shije të huaj.
4. Forma dhe madhësia e kokrrës: e prerë gjerazi, në diametrin më të madh
1. Diametri: - Kultivarët me kokërr të zgjatur, jo më pak se 70 mm

- Kultivarët me kokërr të rrumbullakët, jo më pak se 80 mm
- Kultivarët me kokërr të vogël, jo më pak se 60 mm

DEMTIME MEKANIKE NUK LEJOHEN

1. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.
2. Të kalbura, të ngrira, njolla nga Monilia (kalbëzimi), lëndë të huaja nuk lejohen.
3. Nga krimbi (pa galeri në brendësi) nuk lejohen.
4. Nga fluzikladi (kroma e pikalorja) nuk lejohen.
5. Të gjitha dëmtimet e sipërme nuk lejohen.
6. Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.
7. Gunga (kallo), njolla në lëkurë nuk lejohen.
8. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen.
9. Përmbajtja e pesdiciteteve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Frutat: të amballazhohen të ndara sipas kultivareve në arka të prodhuara sipas stadarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.
2. Frutat mund të amballazhohen edhe në qeskaplasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.
3. Transporti i frutave bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno- sanitare për transporimin e produkteve.
4. Mbi çdo amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.

MARKETIMI

1. Firma prodhuese
2. Lloji i prodhimit
3. Cilësia
4. Masa neto dhe bruto

“PORTOKALL” (bazuar në STASH 1722/88)

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Lloji: portokall për treg, cilësia e parë
2. Pamja e jashtme: të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha e me bisht.
3. Para dhe pas 15 janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %, me pjekuri teknike të plotë.
4. Ngjyra dhe shija dhe aroma: ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët, pa shije të hidhur.
5. Diametri: më i madh jo më pak se 70 mm

DEMTIME MEKANIKE NUK LEJOHEN

1. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.
2. Të kalbura, të mykura, dhe të fermentuara nuk lejohen.
3. Lëndë të huaja nuk lejohen.
4. Gërvishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.
5. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.
6. Të prekura nga oleooza lejohen 2- 3 njolla për kokërr.
7. Përmbajtja e pesdiciteteve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Frutat: të amballazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas stadarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.
2. Frutat mund të amballazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.
3. Transporti i frutave bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno- sanitare për transporimin e produkteve.
4. Mbi çdo amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.

MARKETIMI

1. Firma prodhuese
2. Lloji i prodhimit
3. Cilësia
4. Masa neto dhe bruto

“BANANE”

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Lloji: banane për treg, cilësia e parë
2. Pamja e jashtme: të freskëta, me zhvillim normal, në tufë, me pjekuri teknike të plotë
3. Ngjyra dhe shija: ngjyra të jetë jeshile në të verdhë, me erë të këndshme, karakteristike e këtij kultivari.
4. Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë

DEMTIME MEKANIKE NUK LEJOHEN

1. Njolla të kafeta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.
2. Gërvishtje të lëkurës nuk lejohen.
3. Zbutje të lëkurës nuk lejohen.
4. Të prekura nga oleooza lejohen 2- 3 njolla për kokërr.
5. Përmbajtja e pesdiciteteve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi të jetë në kuti kartoni standarte tipike për tregëtimin e bananes.
2. Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë

“MANDARINË”

Klasifikimi

Lloji : cilësi e parë, e freskët

Treguesit cilësorë:

- Pamja e jashtme: Kokrra me zhvillim normal, të pastra, me bishta të prerë afër sipërfaqes së kokrrës. Me pjekuri teknike të plotë.
- Ngjyra, shija dhe aroma: Karakteristike për mandarinat, pa erë dhe shije të huaj. Grupi i satsumave dhe klementina me ngjyrë jeshile me nuancë të verdhë.
- Madhësia e kokrrës (diametri më i madh), mm, jo më pak se: Për satsumat: 50. Për të tjerat: 45.
- Dëmtime mekanike: Nuk lejohen, të prekura nga sëmundjet dhe insektet, të kalbura, të mykura dhe të fermentuara, gjithashtu nuk lejohen lëndë të huaja, gërvishtje në sipërfaqe, por pa prekur tulin. Nuk lejohen as zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi,

- Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferike

“TRAHANA”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Trahana e prodhuar në kushte industriale, e kokrëzuar. Gjatë tregëtimit të zbtohen rregullat higjeno-sanitare e veterinarë në fuqi. Të plotësojë treguesit organo-leptik dhe to fiziko-kimik.

AMBALAZHIMI:

1. Në qese të përshtatshme kartoni të veshura brenda ,me etiketa. Të shënohet lloji i produktit dhe emir i subjektit. Ruajtja dhe transportimi në temperaturë 2-8 gradë nga subjekti me mjete frigoriferike sipas orarit të kërkuar nga ana jonë.

“SALCË DOMATE”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

-
1. Pamja e jashtme: Të jetë e cilësisë së parë, prodhim domate, e ambalazhuar në shishe qelqi ose kanaçe, ku të jenë të shënuara origjina, data e prodhimit dhe e skadencës. Nga pamja e jashtme të ketë masë të njëllotë, jo fibroze pa fara pa copa e lëkura domatesh, pa pjesë të prishura ose të fermentura.
 2. Ngjyra: E kuqe deri e kuqe e thellë.
 3. Shija dhe era: Me shije dhe erë karakteristike të salcës së domates.

TREGUESIT FIZIKO KIMIK:

1. Të jenë të pranueshme si: aciditeti në kufijt 0.1%; përmbajtja e sheqerit deri në 20%; klorurit të natriumit (NACL) jo më shumë se 1.3-2%.
2. Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

“ÇAJ MALI” (Natyral)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Lloji: çaj mali
2. Era dhe shija: erë dhe shije normale karakteristike e çajit
3. Cilësia: të jetë cilësi e pare, i pastër nga barishtet dhe papastërti, pa lagështi.
4. Ngjyra: të jetë karakteristikee tij e gjelbërt e lehtë.

“ÇOKOKREM”

1. Çokokremi të jetë cilesi ekstra,mase homogjene ne trajte kremi me kakao,lajthi,qersh, dhe qumësht pluhur,pa konservues.
2. Perberesit: Qumesht pluhur, sheqer, yndyrna 26% Kakao ,lajthi 10 – 12%.
3. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
4. Amballazhimi hermetik me vazo plastike me peshe 1 Kg. me etiketë.

“BISKOTA”

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Të jenë të paketuara të ndara në pako me 20 copë secila.
2. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
3. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
4. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
5. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.

6. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
7. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
8. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pikë si të etiketës origjinale.

VAJ LULEDIELLI (USHQIMOR)

Bazuar në SSH 203:2003 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore: Treguesit Shqisorë:

- Pamja: Lëng vajor i qartë, pa depozitime.
- Ngjyra: E verdhë e lehtë.
- Era dhe shija: Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.
- Numri i peroksideve: jo me shume se 10 mek O₂ aktiv / kg Vaj.
- Numri i aciditetit: jo më shumë se 0.4 mg KOH/g vaj. Treguesit Fiziko - Kimik:
- Aciditeti si acid oleik: 0.2 gr ne 100 gr/ Vaj.
- Dendësia relative (20°C/ ujë në 20°C): 0.918 - 0.923.
- Numri sapunifikimit (mg KOH/g vaj): 188 - 194.
- Treguesi i jodit(Ëijs): 118 - 141. - Lëndë të pasapunifikueshme: ≤ 15 g/ kg.
- Treguesi i refraksionit (nD 40) : 1.461-1.468.

Ambalazhimi dhe etiketimi Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

- Origjina e produktit
- Emri i prodhuesit
- Emërtimi i produktit
- Pesha neto - Lloji
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Kur konsiderohet e arsyeshme nga AK, të paraqitet raport-analizë fiziko-kimike e cila duhet të kryhet në një laborator zyrtar të referencës ose të akredituar (vendas ose i huaj) sipas legjislacionit në fuqi.

Ruajtja dhe transportimi Vaji i lulediellit ruhet në mjedise të pastra, pa lagështirë dhe të ajrosura. Transportimi i vajit bëhet me mjete transporti të caktuara për produktet ushqimore.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

PETA TË THATA

Bazuar në SSH 1460:1987 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore Treguesit shqisorë:

- Pamja e jashtme: Formë e rregullt, katrore, trekëndësh, e rumbullakët etj.

Në brendësi e pjekur mirë, pa gjurmë brumi dhe djegie. - Ngjyra: Karakteristike e petave dhe e brumit të pjekur mirë.

- Era dhe shija: Shije dhe erë e këndshme, karakteristike e përbërësve.

Pa erë dhe shije të yndyrës ose të huaj. Treguesit fiziko- kimik dhe shqisorë sipas SSH 1460:1987 ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja e transportimi Sipas SSH 3755:1987 “Prodhime të pastiçerisë. Ambalazhimi, ruajtja dhe transportimi”, ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Transporti të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë Treguesit fiziko-kimik të pasqyrohen në etiketë.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: **Afatet e lëvrimit:**

Lëvrimi i mallrave objekt prokurimi, do të bëhet nga data e lidhjes së kontratave deri në përfundimin e tyre dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në magazinën e Bashkisë Klos, me mjetet e furnizuesit.

Afatet e lëvrimit: 12 muaj

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Liçencë, kategoria II.1.A(1) “Per prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerëz”, e cila te perfshije te pakten nje nga artikujt objekt prokurimi.

Liçencë, kategoria II.1.B, Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit).

Shenim: Nuk lejohet perdorimi i licenses se nje operatori tjeter ekonomik (Rekomandim i përbashkët i APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet e viteve, tre viteve të fundit 2023,2024,2025, të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2026 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përgjindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Vertetim per numrin mesatar te punonjesve per periudhen kohore 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar, jo me i vogel se 3 punonjës, i vertetuar nga organet tatimore per te mundesuar realizimin e kontrates me sukses.

Ne lidhje me kete pike te paraqitet: Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar si dhe listepagesat per secilin muaj.

Disponimi i punonjesve si me siper do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarrës te paraqese raport analize per produktin buke te leshuar jo me pare se 30 dite nga hapja e ofertave dhe te leshuar nga laboratore te licensuar dhe akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të lëshuara nga Institucioni përkatës i akreditimit:

Iso 22000:2018 ose ekuivalente me te

ISO 9001:2015 ose ekuivalente me te

Certifikatat duhet të jenë në fuqi, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.3.5 Ofertuesi duhet të disponojë **magazinë ushqimore dhe ambiente frigoriferike** në pronësi osë në përdorim sipas kontratës noteriale me sipërfaqe jo më pak se 50 m² të pajisur me licecë II.1.B, akt miratim higjeno sanitar, raport analizën e ujit të rrjetit, certifikaten e mbrojtjes ndaj zjarrit, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambientit të ushtrimit të aktivitetit.

2.3.6 Furre buke në pronësi ose në përdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale, te pajisur me leje higjeno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), certifikaten e dezinfektimit 3D, certifikaten e mbrojtjes nga zjarri si dhe raport analizen e ujit te rrjetit. Per produktin e mesiperm ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate funrizimi te zyrtarizuar me nje subjekt prodhues e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

2.3.7 Njesi prodhimi bulmeti ne pronesi ose perdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: leje higjeno

sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (per trajtimin dhe perpunimin e qumeshtit), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B si dhe Certifikaten e dezinfektimit 3D. Per produktin e mesiperm ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

2.3.8 Thertore ne pronesi ose perdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale te pajisur me: leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Per thertoren te paraqitet vertetim nga AKU qe thertorja eshte funksionale (ne kuader te nismave qeveritare ne kete fushe). Per produktin e mesiperm ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti, nga te cilat 1 (nje) frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronesie ose kontrate qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikate transporti (te paraqitet automjet i cili pajiset me kete certifikate sipas legjislacionit ne fuqi), librezat shendetesore se bashku me raportet mjeko-ligjore si dhe lejet e drejtimit te drejtuesve te mjeteve.

- Disponimi i automjeteve do të deklarohej në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.10 Ne rrespektim dhe zbatim te rekomandimeve te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se mjeti frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve objekt i kësaj procedure, kane rregjister perkates per monitorimin e temperatures sipas Udhezimit te Ministrise se Bujqesise nr.22, date 25.11.2010 ” Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”*Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme os të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁷.

⁷Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet

këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje

